

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.03.2023*

28.03.2023

Ora 12:40

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Shqyrtimi paraprak i kërkesës nr. 11 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vendosje sanksioni”.**

**PJESËMARRJA :**

**KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.

**Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.

**Të tjerë:** S’ka prezent

**Z. L. Braho:** Atëhere përshendetje! Çelim seancën e verifikimit të plotësimit të formës dhe përmbajtjes së kërkesës. Do shqyrtojmë kërkesën numër 11, të datës 25 mars 2023 në zbatim, që është depozituar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të nenit 21, pika 1 shkronja dh e Kodit Zgjedhor. Në këtë seancë do të shqyrtojmë element verifikimin dhe plotësimin e formës dhe të përmbajtjes së kësaj kërkesë, më konkretisht Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka drejtuar KAS kërkesën për vendosje sanksioni administrative ndaj 10 personave. Kërkesa parë ka të bëjë me BAshkinë Fier, kërkesa dytë ka të bëjë me Bashkinë Përrenjas, kërkesa tretë me Bashkinë Librazhd, kërkesa katërt i përket Prefektit Qarkut Gjirokastrë, kërkesa pestë Bashkia Poliçan, kërkesa gjashtë Bashkia Skrapar, kërkesa shtatë Bashkia Roskovec, kërkesa tetë Bashkia Lezhë, kërkesa nëntë Bashkia Bulqizë dhe kërkesa dhjetë Bashkia Elbasan. Atëhere i pranishëm është dhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, për palët besoj është kryer njoftimi dhe nuk është asnjë nga palët e pranishme, kështu që fjala është për Sekretarin e Përgjithshëm për një relativ

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.03.2023*

të shkurtër në lidhje me këtë kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sa i përket elementeve të formës dhe të përmbajtjes. Faleminderit!

**Z. Y. Merkaç:** Po, faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë disa denoncime për organizimin e 20 veprimtarive publike, nga 10 institucione publike, për shkelje administrative në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, të Komisionit rregullator të vitit 2020 për disa kryetar bashkie dhe personat përgjegjës, të cilët kanë për detyrë të raportojnë veprimtaritë publike. Në përfundim të hetimit administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me kërkesën nr. 11, i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për vendosje sanksioni administrative për kryetarin e Bashkisë Fier, kryetarin e Bashkisë Përrenjas, kryetarin e Bashkisë Librazhd, për personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Poliçan, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Skrapar, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Roskovec, personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Lezhë, në Bashkinë Bulqizë dhe në Bashkinë Elbasan. Kërkesa është e bazuar dhe plotëson elementët formal të Kodit Zgjedhor, dhe i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ta shqyrtojë në seancë. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** : Faleminderit zoti Merkaç! KAS pasi u konsultua në vend vendosi, në zbatim të nenit 129, pika 3, shkronja a, kalimin e kërkesës nr.11, datës 25.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtim, duke qënë se i plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes, seanca për shqyrtimin administrative të kësaj

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.28.03.2023*

kërkese ankimore caktohet nesër në datë 29 mars, ora 12.30. U shpall sot në Tiranë,  
datë 28.03.2023. Seanca deklarohet e mbyllur!

**Vendimi nr. 34**

*Zbardhi materialin audio  
Andoneta GJIKNURI*

